



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS**  
**Gjuhësi e Zbatuar**

**Ngarkesa:** 6 kredite, 30 orë mësimore leksione, 30 orë mësimoreseminare  
**Viti /Semestri:** Viti I, sem II  
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme  
**Programi i studimit:** Master i Shkencave, ‘‘Mësuesi në Gjuhë Angleze’’  
**Kodi i Etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

***Objektivat e përgjithshëm lëndore:***

Të pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi lidhjen ndërmjet teorisë dhe praktikës në fushën e gjuhësisë së zbatuar. Të ndërgjegjësojë studentët për rëndësinë e analizës kritike të teorisë dhe praktikave në mësimdhënien e gjuhëve të huaja. Të nxisë aftësinë për të zbatuar konceptet gjuhësore në mënyrë funksionale dhe të vetëdijshme në kontekste reale mësimore dhe gjuhësore.

***Objektivat specifike lëndore :***

1. Të zhvillojë aftësinë për të analizuar përvojat mësimore në mënyrë kritike dhe reflektuese.
2. Të aftësojë studentët për të mbledhur, organizuar dhe analizuar të dhëna gjuhësore për qëllime kërkimi ose mësimdhënieje.
3. Të përgatisë studentët për të ndërtuar plane mësimore të bazuara në parime teorike të qëndrueshme, të zbatueshme në klasë.

***Rezultatet e pritshme:***

Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:

1. Aplikojnë parime të gjuhësisë së zbatuar në situata konkrete të mësimdhënies së gjuhës së huaj.
2. Vlerësojnë në mënyrë kritike ndikimin e faktorëve gjuhësorë, kulturorë dhe pedagogjikë në mësimnxënie.
3. Propozojnë zgjidhje të përshtatshme për sfida që lidhen me mësimin dhe përdorimin e gjuhës në shoqëri shumëgjuhëshe dhe në klasë.